



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 66/2016

“PËR SHËRBIMET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”¹

Në mbështetje të neneve 78, 81, paragrafi 1 dhe 83, paragrafi 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 66/2016 “Për shërbimet në Republikën e Shqipërisë” bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Fjalja e parë e nenit 1 riformulohet si më poshtë:

“Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë parimet themelore dhe kriteret që garantojnë të drejtën e vendosjes dhe të drejtën e ushtrimit të aktivitetit ndërkufitar për ofruesit e shërbimeve në Republikën e Shqipërisë, duke garantuar cilësi të lartë të shërbimeve për përfituesit e tyre.”.

Neni 2

Në nenin 2, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë numërohet 1 dhe ndryshohet, si më poshtë:

¹ Ky ligj është përafruar plotësisht me direktivën 2006/123/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 12 dhjetor 2006 “Mbi shërbimet në tregun e brendshëm”, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, Nr. 376, datë 27.12.2006, faqe 36–68.

“1. Ky ligj zbatohet për të gjitha shërbimet që ofrohen nga ofruesit e vendosur në Republikën e Shqipërisë, ose në një Shtet Anëtar, me përjashtim të:”

2. Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) shërbimeve financiare, sipas përkufizimit të këtij ligji”.

3. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) shërbimeve në fushën e transportit duke përfshirë, transportin ajror, transportin detar dhe të brendshëm ujor, duke përfshirë shërbimet portuale dhe transportin rrugor e hekurudhor, duke përfshirë në veçanti transportin urban, taksitë dhe ambulancat.”

4. Shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) aktiviteteve të lojërave të fatit që përfshijnë vënien e një basti me vlerë monetare në lojëra të fatit, duke përfshirë lotaritë, lojërat e fatit në kazino dhe transaksionet e basteve.”

5. Shkronja “g” ndryshohet si më poshtë:

“g) shërbimeve sociale që lidhen me strehimin social, kujdesin për fëmijët dhe mbështetjen e familjeve dhe personave që janë në nevojë të përhershme ose të përkohshme, të cilat ofrohen nga Shteti, nga ofrues të autorizuar nga Shteti ose nga organizata bamirëse të njohura si të tilla nga Shteti.”

6. Shkronja “gj)” shfuqizohet.

7. Shkronja “h)” , “i)” dhe “j)” emërohen përkatësisht “gj)”, “h)” dhe “i)”

8. Pas pikës 1 shtohet pika 2, me këtë përmbajtje:

“2. Dispozitat e këtij ligji nuk rregullojnë:

- a) liberalizimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik, të rezervuara për subjektet publike ose private;
- b) privatizimin e subjekteve publike që ofrojnë shërbime;
- c) heqjen e monopoleve në fushën e ofrimit të shërbimeve;
- ç). ndihmat e dhëna nga Shtetet Anëtarë të mbuluara nga rregullat e Bashkimit Evropian mbi konkurrencën;
- d) lirinë e përcaktimit të shërbimeve që konsiderohen si shërbime me interes të përgjithshëm ekonomik, mënyrën e organizimit dhe financimit të tyre, në përputhje me parashikimet e ndihmës shtetërore, si dhe detyrimet specifike të cilave u nënshtrohen këto shërbime;

- dh). ushtrimin e të drejtave themelore, të drejtën për të negociuar, lidhur dhe zbatuar marrëveshje kolektive;
- e) dispozitat e legjislacionit të punës, duke përfshirë rregullat e shëndetit dhe sigurisë në punë;
- ë). dispozitat e legjislacionit të sigurimeve shoqërore;
- f) dispozitat e të drejtës penale;
- g) rregullat për mbrojtjen dhe promovimin e diversitetit kulturor ose gjuhësor dhe pluralizmin e medias;
- gj). fushën e taksave.”

Neni 3

Pas nenit 2 shtohet neni 2/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Marrëdhënia me ligjet e posaçme

1. Nëse ndonjë nga dispozitat e këtij ligji bie në kundërshtim me dispozitat e ligjit të posaçëm që rregullon veprimtaritë e shërbimeve në një sektor specifik ose profesione specifike, dispozitat e ligjeve të posaçme kanë përparësi. Kjo dispozitë zbatohet për legjislacionin që ka të bëjë me transferimin e përkohshëm e punëmarrësve në kuadër të ofrimit të shërbimeve, me ushtrimin e aktiviteteve të transmetimit televiziv, për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe për zbatimin e skemave të sigurimeve shoqërore për personat e punësuar, personat e vetëpunësuar dhe anëtarët e familjeve të tyre.

2. Përveç nëse parashikohet ndryshe nga ky ligj, dispozitat e ligjit për njohjen e kualifikimeve profesionale zbatohen në përputhje me të gjitha procedurat e këtij ligji që lidhen me profesionet e rregulluara dhe njohjen e kualifikimeve të huaja profesionale për qëllim të ushtrimit të veprimtarive të shërbimeve.

3. Përveç nëse parashikohet ndryshe nga ky ligj, dispozitat e ligjit që rregullon licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë, zbatohen në përputhje me parashikimet e këtij ligji që lidhen me çështjet administrative.

4. Parashikimet e këtij ligji nuk zbatohen për rregullat e të drejtës ndërkombëtare private, në veçanti normat që rregullojnë legjislacionin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore, duke përfshirë edhe ato që garantojnë që konsumatorët të përfitojnë nga mbrojtja që u japin rregullat e mbrojtjes së konsumatorëve të parashikuara në legjislacionin për konsumatorët në fuqi.

5. Dispozitat e ligjit zbatohen në përputhje me parimet dhe angazhimet ndërkombëtare për të parandaluar pengesat e panevojshme në ushtrimin e të drejtës së vendosjes dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve ndërkufitare.

Neni 4

Në nenin 3, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Arsye madhore të lidhura me interesin publik” nënkupton arsye të njohura si të tilla në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, si rendi publik, siguria publike, mbrojtja publike, shëndeti publik, ruajtja e ekuilibrit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore, mbrojtja e konsumatorëve, përfituesve të shërbimeve dhe punonjësve, ndershmëria e dhe drejtësia e transaksioneve tregtare, lufta ndaj mashtrimit, mbrojtja e mjedisit dhe e ambientit qytetës, shëndeti i kafshëve, pronësia intelektuale, ruajtja e trashëgimisë historike dhe kulturore kombëtare, objektivat e politikës sociale dhe objektivat e politikës kulturore.”

2. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1, me këtë përmbajtje:

“4/1. “**Komision**” nënkupton Komisionin Evropian, institucionin më të lartë ekzekutiv të Bashkimit Evropian.”

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “Kriter” është çdo detyrim, ndalim, kusht apo kufizim i parashikuar në dispozitat e legjislacionit sektorial ose si pasojë e praktikës gjyqësore, praktikës administrative, rregullave të organeve profesionale apo rregullave të përbashkëta të shoqatave profesionale apo organizatave të tjera profesionale, të miratuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre në mënyrë autonome. Për qëllime të këtij ligji, rregullat e vendosura në marrëveshjet kolektive nuk konsiderohen si kushte të tilla.”

4. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e ekonomisë dhe të tregtisë.”

5. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. “Ofrues” është çdo individ, i cili është shtetas i Republikës së Shqipërisë ose i një Shteti Anëtar ose person juridik i vendosur në Republikën e Shqipërisë apo në një Shtet Anëtar, që ofron shërbime.”

6. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

“9. “Përfitues” është çdo individ, i cili është shtetas shqiptar ose i një Shteti Anëtar, apo që përfiton nga të drejtat që i japin aktet e Bashkimit Evropian, si dhe çdo person juridik i vendosur në Republikën e Shqipërisë ose në një Shtet Anëtar që, për qëllime profesionale ose jo, përdor ose dëshiron të përdorë një shërbim.”

7. Pas pikës 10 shtohet pika 10/1, me këtë përmbajtje:

“10/1. “**Sistemi i Informacionit të Tregut të Brendshëm**” - (*Internal Market Information System - IMI*), sistem informacioni shumëgjuhësh *on-line* që lehtëson shkëmbimin e informacionit midis autoriteteve publike të përfshira në zbatimin praktik të ligjit të Bashkimit Evropian, rregulluar nga Rregullorja (BE) Nr. 1024/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 25 tetor 2012 mbi bashkëpunimin administrativ përmes Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm.”

8. Pika 12, ndryshohet si më poshtë:

“12. “**Shërbim**” është çdo veprimtari ekonomike, e kryer nëpërmjet vetëpunësimit, kundrejt një shpërblimi, si edhe çdo lloj veprimtarie me karakter intelektual apo manual, e zhvilluar në formën e sipërmarrjes apo në atë profesionale, në mënyrë të pavarur dhe kundrejt një shpërblimi.”

9. Pas pikës 14 shtohen pikat 14/1, 14/2, 14/3 dhe 14/4 me këtë përmbajtje:

“14/1. “**Shërbime financiare**” nënkupton shërbimet bankare, kreditimin, sigurimin e risigurimin, pensionet profesionale e personale, letrat me vlerë, fondet e investimeve, pagesat dhe këshillimin për investimet si dhe tërësinë e shërbimeve të parashikuara në Aneksin 1 të Direktivës 2013/36/BE, përkatësisht: marrjen e depozitave dhe fondeve të tjera të ripagueshme, huadhënien përfshirë, ndër të tjera: kredinë konsumatori, marrëveshjet e kredisë lidhur me pasurinë e paluajtshme, faktoringun, financimin e transaksioneve tregtare, qiratë financiare, shërbimet e pagesave, lëshimin dhe administrimin e mjeteve të tjera të pagesave, garancitë dhe angazhimet, tregtimin për llogari personale ose për llogari të klientit, lidhur me: instrumentet e tregut financiar (çeqe, fatura, certifikata depozitash, etj.), valutë e huaj; kontratat e paracaktuara (*futures*) dhe opsionet; instrumentet e këmbimit dhe normave të interesit; letrat me vlerë të transferueshme, pjesëmarrjen në emetimin e letrave me vlerë dhe ofrimin e shërbimeve që lidhen me këto emetimet, këshillimin lidhur me strukturat e kapitalit, strategjitë dhe çështje të ndërlidhura me to, si dhe këshillimin dhe shërbimet lidhur me bashkimet dhe blerjet e shoqërive, ndërmjetësimin në tregun financiar, menaxhimin e portofolit dhe këshillimin, ruajtjen dhe administrimin i letrave me vlerë, shërbimet e referencës së kreditit, shërbime të sigurimit të depozitave, emetimin e tokenave digjital të aseteve, emetimin e parasë elektronike, shërbimet me tokenat digjital të aseteve.”

14/2. **“Shtet Anëtar”** nënkupton çdo Shtet Anëtar të Bashkimit Evropian ose shtet kontraktues të Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE).

14/3. **“Shteti i Vendosjes”** nënkupton Republikën e Shqipërisë, çdo Shtet Anëtar të BE-së, Bashkimit ose çdo shtet kontraktues të Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE), ku ofruesi i shërbimit është i vendosur.

14/4 **“Shteti ku ofrohet shërbimi”** nënkupton çdo Shtet Anëtar të Bashkimit Evropian dhe çdo shtet kontraktues të Zonës Ekonomike Evropiane (ZEE), ku shërbimi ofrohet nga një ofrues i vendosur në një Shtet Anëtar tjetër.

10. Pika 15 ndryshohet si më poshtë:

15. **“Themelimi”** nënkupton krijimin dhe regjistrimin fillestar të një subjekti fizik ose juridik me qëllim ushtrimin e një veprimtarie ekonomike sipas legjislacionit të shtetit përkatës;

11. Pas pikës 15 shtohet pika 16, me këtë përmbajtje:

16. **“Vendosje”** nënkupton themelimin ose ushtrimin e një aktiviteti ekonomik, nga ofruesi për një periudhë të pacaktuar dhe nëpërmjet një infrastrukture të qëndrueshme nga ku kryhet realisht ofrimi i shërbimeve.

Neni 5

1. Titulli i Kreut II, ndryshohet si më poshtë: **“E DREJTA E VENDOSJES DHE SKEMAT E AUTORIZIMIT”**
2. Titulli i Seksionit 1, ndryshohet si më poshtë: **“E drejta e vendosjes”**

Neni 6

Në nenin 5 bëhen këto shtesa:

1. Paragrafi i parë ndryshohet si më poshtë;

“Ushtrimi i veprimtarisë për ofrimin e një shërbimi në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga persona fizikë ose juridikë, të vendosur në një nga Shtetet Anëtare sipas legjislacionit në fuqi, nuk mund të kushtëzohet, në asnjë rast, nga:”

2. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/1, 1/2 dhe 1/3 si më poshtë:

“1/1. Ndalimi për të pasur një vendosje në më shumë se një Shtet Anëtar ose për t’u regjistruar në regjistra ose në organizata profesionale ose shoqata në më shumë se një Shtet Anëtar;

1/2. Kufizime mbi lirinë e ofruesit për të zgjedhur ndërmjet një vendosjeje kryesore ose dytësore, veçanërisht detyrimin për ofruesin që të ketë vendosjen kryesore në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose kufizime mbi lirinë për tu vendosur në formën e një agjencie, dege ose adrese dytësore;

1/3 Kushte të reciprocitetit me Shtetin Anëtar në të cilin ofruesi tashmë ka një vendosje, me përjashtim të rasteve të kushteve të reciprocitetit të parashikuara në instrumentet e Bashkimit Evropian në lidhje me energjinë.”.

3. Në pikën 4 togfjalëshi “në territorin e tyre” zëvendësohet me togfjalëshin “ në territorin e Republikës së Shqipërisë”.
4. Në pikën 5 togfjalëshi “në territorin e tyre” zëvendësohet me togfjalëshin “ në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Neni 7

Në nenin 6, bëhen këto shtesa:

1. Në pikën 1, shkronja d, pas fjalës “territorit” shtohet togfjalëshi “të Republikës së Shqipërisë”.

2. Pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtje si më poshtë:

“4. Ministria njofton Komisionin për çdo nismë ligjore në përputhje me parashikimet e këtij neni. Njoftim nuk pengon vijimin e procedurave për miratimin e nismës. Nisma ligjore nuk miratohet më tej ose shfuqizohet, në rast se Komisioni merr vendim dhe i kërkon autoritetit kompetent të heqë dorë nga miratimi i nismës ose ta shfuqizojë atë.

5. Parashikimet e këtij neni do të zbatohen për legjislacionin në fushën e shërbimeve të interesit të përgjithshëm ekonomik vetëm në masën që zbatimi i këtyre parashikimeve nuk pengon përmbushjen, në mënyrë ligjore ose faktike, të detyrës së veçantë që u është caktuar.”

Neni 8

Në nenin 7 bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me përmbajtje si më poshtë:

“1/1. Kushtet për dhënien e autorizimit për fillimin e një shërbimi të ri (vendosjen e re), nuk duhet të përsërisin kërkesat dhe kontrollet që janë barasvlershme ose në thelb të krahasueshme për sa i përket qëllimit, me ato të cilave ofruesi u është nënshtruar më parë në një Shtet Anëtar. Koordinatorët e përcaktuar në nenin 15/4 dhe ofruesi ndihmojnë autoritetin kompetent duke ofruar çdo informacion të nevojshëm në lidhje me këto kërkesa.”

2. Pika 2 e nenit 7, ndryshohet si më poshtë:

“2. Autorizimi i jep mundësi ofruesit të hyjë në një veprimtari shërbimi apo ta ushtrojë një veprimtari të tillë, në të gjithë territorin kombëtar, edhe përmes ngritjes së agjencive, shoqërive të kontrolluara, degëve a zyrave, me përjashtim të rastit kur kërkohet nga një autorizim për çdo vendosje të tillë apo kur autorizimi jepet në mënyrë të kufizuar vetëm për një pjesë të caktuar të territorit e justifikuar kjo me një arsye madhore të lidhur me interesin publik”.

3. Pas pikës 5 shtohen pikat 6, dhe 7, me përmbajtje si më poshtë:

“6. Autoritetet kompetente i kërkojnë ofruesit të informojë Pikën e Vetme të Kontaktit për ndryshimet e mëposhtme:

- a) krijimin e shoqërive të kontrolluara, veprimtaria e të cilave bën pjesë në fushëveprimin e skemës së autorizimit.
- b) ndryshimet në situatën e ofruesit të cilat bëjnë që kushtet për autorizimin të mos përmbushen më.

“7. Ky nen nuk e cënon mundësinë për të revokuar autorizimin, kur kushtet për dhënien e autorizimit nuk përmbushen më.”.

Neni 9

Në nenin 9, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rastet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, skema e autorizimit do të ketë një kohëzgjatje të kufizuar, pa të drejtë rinovimi automatik apo përparësi për ofruesin të cilit sapo i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së autorizimit, si dhe për asnjë person tjetër me lidhje të veçanta me të”.

Neni 10

Pas Kreu II shtohet Kreu II/1 me këtë përmbajtje:

“KREU II/1

LIRIA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NDËRKUFITARE DHE PËRJASHTIMET

Neni 9/1

Liria për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare

1. Ofruesit sipas pikës 8 të nenit 4 të këtij ligji i sigurohet qasje falas për ofrimin e shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Kriteret për ofrimin e shërbimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) jo-diskriminuese, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për shtetësinë dhe, në rastin e personave juridikë, për Shtetin e Vendosjes;
- b) të domosdoshme dhe të justifikuara për arsye të politikës publike, sigurisë publike, shëndetit publik ose mbrojtjes së mjedisit;
- c) proporcionale dhe të përshtatshme për arritjen e objektivit të synuar, pa tejkaluar masën e domosdoshme për arritjen e këtij objekti.

3. Ofruesi nuk mund të kufizohet në lirinë për të ofruar shërbime ndërkufitare në territorin e Republikës së Shqipërisë nëpërmjet parashikimeve të mëposhtme:

- d) Detyrimit për ofruesin për tu vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- e) Detyrimi që ofruesi të marrë një autorizim nga autoritetet kompetente shqiptare duke përfshirë edhe regjistrimin pranë një regjistri ose një organi a shoqate profesionale, përveç rasteve të parashikuara në këtë ligj ose akte të tjera të posaçme;
- f) Ndalimit për të ngritur një strukturë të çdo lloji dhe forme në territorin shqiptar, e cila është e nevojshme për të realizuar shërbimet në fjalë;
- ç). Zbatimit të marrëveshjeve specifike kontraktore ndërmjet ofruesit dhe përfituesit të cilat pengojnë ose kufizojnë ofrimin e shërbimeve nga të vetëpunësuarit;
- g) Detyrimit të ofruesit për të zotëruar një dokument identifikimi të posaçëm për ushtrimin e një veprimtarie shërbimi, të lëshuar nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë;
- dh) Kërkesat, përveç atyre të nevojshme për shëndetin dhe sigurinë në punë, të cilat ndikojnë në përdorimin e pajisjeve dhe materialeve që janë pjesë përbërëse e shërbimit të ofruar;
- h) Kriteret e parashikuara në nenin 13 të këtij ligji.

4. Kushtet e justifikuara për arsye të rendit publik, sigurisë publike, shëndetit publik ose mbrojtjes së mjedisit dhe në përputhje me paragrafin 1, mund të vendosen ndaj ofruesve të shërbimeve ndërkufitare, me kusht që këto kushte të jenë proporcionale me mbrojtjen e kategorive të sipërpërmendura.

Neni 9/2

Përfshirjet nga liria për të ofruar shërbime ndërkufitare

Neni 9/1 nuk zbatohet për:

- a) Shërbimet me interes të përgjithshëm ekonomik që ofrohen në një Shtet Anëtar, ndër të tjera:
 - i. Shërbimet në sektorin postar;
 - ii. Shërbimet në sektorin e energjisë elektrike;
 - iii. Shërbimet në sektorin e gazit natyror;
 - iv. Shërbimet për shpërndarjen dhe furnizimin me ujë të pijshëm dhe shërbimet e ujërave të zeza;
 - v. Shërbimet për trajtimin e mbetjeve;
- b) Ofrimin e shërbimeve nga punëtorët e transferuar përkohësisht;
- c) Çështjet lidhur me mbrojtjen, përpunimin dhe transferimin e të dhënave personale të personave fizikë;
- ç) Shërbimet e avokatisë;
- d) Shërbimet përmbartimore;
- dh) Çështjet lidhur me kualifikimet profesionale dhe shërbimet e rezervuara për një profesion të veçantë në Shtetet Anëtare ku ofrohet shërbimi;
- e) Çështjet lidhur me zbatimin e skemave të sigurimeve shoqërore për të punësuarit, të vetëpunësuarit dhe për anëtarët e familjes së tyre;
- ë. Sa i përket procedurave administrative të Shtetit Anëtar ku ofrohet shërbimi në lidhje me lëvizjen e lirë të personave dhe vendbanimit të tyre.
- f) Sa i përket shtetasve të vendeve të treta që nuk mbulohen nga regjimi i njohjes së ndërsjellë, të cilët lëvizin në një Shtet Anëtar në kuadër të ofrimit të një shërbimi, mundësia që Shtetet Anëtare të kërkojnë viza ose leje qëndrimi për shtetasit e vendeve të treta;
- g) Shërbimet e transportit të mbetjeve brenda, në hyrje dhe jashtë Bashkimit Evropian;
- gj) Të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e lidhura me to, mbrojtja ligjore e topografisë së produkteve gjysëmpërçuese, mbrojtja e bazave të të dhënave dhe të drejtat e pronësisë industriale;
- h) Shërbimet noteriale;
- i) Shërbimet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore dhe të pasqyrave financiare të konsoliduara;
- j) Regjistrimin e automjeteve të lëshuara me qira nga një tjetër Shtet Anëtar;
- k) Detyrimet kontraktore dhe jashtëkontraktore, duke përfshirë formën e kontratave, të vendosura në përputhje me normat e së drejtës ndërkombëtare private.

Neni 9/3

Përfjashtimet në raste individuale

1. Si përfjashtim nga neni 9/1, dhe vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, autoriteti kompetent mund të marrë masa në lidhje me sigurinë e shërbimeve për një ofrues të vendosur në një Shtet Anëtar.

2. Masat e parashikuara në pikën 1 mund të merren vetëm nëse është ndjekur procedura e përcaktuar në nenin 15/10 dhe janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

- a. dispozitat aktuale në përputhje me të cilat është marrë masa nuk i janë nënshtruar harmonizimit në nivel të Bashkimit Evropian në fushën e sigurisë së shërbimeve;
- b. masat parashikojnë një nivel më të lartë mbrojtjeje të përfituesit sesa do të ishte rasti në një masë të marrë nga Shteti i Vendosies në përputhje me dispozitat e ligjit vendas;
- c. Shteti i Vendosies nuk ka marrë asnjë masë ose ka marrë masa të konsideruara të pamjaftueshme;
- ç. masat janë proporcionale me rrethanat e krijuara.

3. Dispozitat e përcaktuara nga aktet e Bashkimit Evropian, të cilat garantojnë lirinë për të ofruar shërbime ose që lejojnë përfjashtime nga ushtrimi i kësaj lirie kanë përparësi mbi parashikimet e pikës 1 dhe 2, të këtij neni.”

Neni 11

Në pikën 4 të nenit 11 pas togfjalëshit “përfituesit e shërbimeve” shtohet togfjalëshi “sa më shpejt”

Neni 12

Kreu IV ndryshohet si më poshtë:

“KREU IV

TË DREJTAT E PËRFITUESVE DHE CILËSIA E SHËRBIMEVE

Seksioni 1

Të drejtat e përfituesve të shërbimeve

Neni 13

Të drejtat e përfituesve të shërbimeve

1. Çdo përfitues në përputhje me paragrafin 9 të nenit 3 të këtij ligji, mund të përfitojë nga shërbimet e ofruara në territorin e Republikës së Shqipërisë pa qenë i detyruar të pajiset me një autorizim apo të bëjë deklaratë para autoriteteve kompetente për këtë qëllim.

2. Autoritetet kompetente nuk mund të vendosin kufizime që pengojnë apo vështirësojnë përdorimin e një shërbimi të ofruar nga një ofrues i vendosur në Republikën e Shqipërisë apo në një Shtet Anëtar, përfshirë në mënyrë të veçantë:

- kërkesave për autorizim ose për deklaram paraprak;
- kufizime diskriminuese mbi dhënien e ndihmës apo mbështetjes financiare për përfituesit, për shkak të vendosjes së ofruesit në një Shtet Anëtar ose për shkak të vendit të ofrimit të shërbimit.

3. Autoritetet kompetente sigurojnë që kushtet e përgjithshme për përfitimin e një shërbimi të caktuar, të bëra publike nga ofruesi, nuk përmbajnë kritere diskriminuese, lidhur me shtetësinë apo vendin e qëndrimit të përfituesit. Ndryshimet, në kushtet për përfitimin nga shërbimi, lejohen vetëm kur justifikohen drejtpërdrejt nga kritere objektive.

4. Përfituesit e shërbimeve kanë të drejtë të kërkojnë dhe të marrin në territorin e Republikës së Shqipërisë, informacione të përgjithshme mbi:

- a) kërkesat e zbatueshme për ushtrimin e veprimtarisë së ofrimit të shërbimeve e përfitimin prej tyre dhe ato që lidhen me mbrojtjen e konsumatorëve;
- b) mjetet e ankimit, në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet ofruesit dhe përfituesit;
- c) të dhënat e kontaktit të shoqatave ose organizatave, duke përfshirë qendrat e Rrjetit Evropian të Qendrave të Konsumatorit (*European Consumer Centres Network*), nga të cilat ofruesit ose përfituesit mund të marrin ndihmë praktike.

5. Kur është e përshtatshme, autoritetet kompetente, vendosin në dispozicion një udhëzues të thjeshtë hap pas hapi, për të përfituar nga të drejtat dhe informacionet e parashikuara në këtë nen. Informacioni dhe ndihma e parashikuar në këtë nen ofrohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të paanshme, në distancë, përfshirë edhe përmes mjeteve elektronike, dhe mbahen të përditësuar.

6. Këshilli i Ministrave përcakton, me vendim, autoritetet ose trupat përgjegjëse për dhënien e informacionit dhe ndihmës sipas këtij neni, përfshirë, sipas rastit, Pikën e Vetme të Kontaktit, qendrat e konsumatorëve, shoqatat përkatëse apo struktura të tjera. Në këtë vendim përcaktohen dhe masat për zbatimin praktik të këtij neni, që sigurojnë funksionimin e ndërveprimit së sistemeve të informacionit dhe përafrimin me standardet e përbashkëta evropiane, në bashkëpunim me Komisionin Evropian.

7. Autoritetet përgjegjëse bashkëpunojnë me autoritetet e Shteteve Anëtare për të mundësuar shkëmbimin efikas të informacionit, përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe ndihmës së ndërsjellë, në përputhje me mekanizmat e përcaktuar në nivel evropian.

Seksioni 2

Informacioni për ofruesit dhe cilësia e shërbimeve

Neni 14

Informacion për ofruesit dhe shërbimet e tyre

1. Ofruesit vendosin në dispozicion të përfituesve informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin, statusin dhe formën juridike, adresën, ku të jenë përcaktuar edhe të dhëna për kontaktim e komunikim të drejtpërdrejtë, sipas rastit, edhe në mënyrë elektronike;
- b) numrin e regjistrimit në regjistrin përkatës në Shtetin e Vendorsjes dhe nëse është e zbatueshme edhe numrin e regjistrimit si subjekt i tatueshëm;
- c) në rastin kur veprimtaria është objekt i autorizimit, të dhëna për autoritetin kompetent për këtë qëllim apo PVK-në;
- ç) në rastin e profesioneve të rregulluara, organin profesional apo ndonjë institucion të ngjashëm, ku ofruesi është regjistruar, titullin profesional dhe Shtetin Anëtar ku e ka fituar këtë titull;
- d) kushtet kontraktore të përgjithshme që përdor ofruesi (nëse ka);
- dh) dispozitat kontraktore, të përdorura nga ofruesi, në lidhje me dispozitat e zbatueshme dhe/ose gjykatat kompetente (nëse ka);
- e) garancitë pas shitjes (nëse ka), jo ato të përcaktuara në ligj;
- ë) çmimin e shërbimit, kur, për një shërbim të caktuar, është paracaktuar një çmim nga ofruesi për një lloj të caktuar shërbimi;
- f) karakteristikat kryesore të shërbimit, nëse nuk janë të qarta nga konteksti;
- g) kontratat e sigurimit dhe garancitë e përgjegjësisë profesionale, të përmendura në nenin 14/1, dhe në veçanti të dhënat e kontaktit të siguresit ose garantuesit si dhe mbulimin territorial.

2. Autoritetet kompetente sigurojnë që informacioni i përmendur në paragrafin 1, sipas preferencës së ofruesit të shërbimit:

- a) të jepet nga vetë ofruesi me nismën e tij;

- b) të jetë lehtësisht i arritshëm nga përfituesi në vendin ku ofrohet shërbimi ose ku lidhet kontrata;
- c) të mund të arrihet lehtësisht në mënyrë elektronike nga përfituesi përmes një adrese të vendosur në dispozicion nga ofruesi;
- ç) të përfshihet në çdo dokument informues që i jepet përfituesit nga ofruesi, i cili përmban një përshkrim të hollësishëm të shërbimit që ofron.

3. Me kërkesë të përfituesve, ofruesit kanë detyrimin të paraqesin informacionin e mëposhtëm shtesë:

- a) çmimin, në rastet kur, për një shërbim të caktuar, ky nuk është paracaktuar nga ofruesi i shërbimit për një lloj të caktuar shërbimi, ose, kur një çmim i saktë nuk mund të jepet, mënyrën e përlllogaritjes së tij apo një vlerë të përafërt të detajuar;
- b) rregullat profesionale të zbatueshme, sa u takon profesioneve të rregulluara, dhe ku gjenden ato;
- c) informacion për veprimtaritë e tjera apo partneritetet, të cilat lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimin e ofruar, dhe masat e marra për të shmangur konfliktin e interesit. Ky informacion përfshihet në çdo dokument informues, ku ofruesi jep një përshkrim të hollësishëm të shërbimit të tij;
- ç) kodin e sjelljes, mbi të cilin mbështetet ofruesi, si dhe adresën në të cilat këto kode mund të konsultohen, në mënyrë elektronike, me treguesin e versioneve gjuhësore të mundshme (nëse ka);
- d) në rastet kur ofruesi është anëtar i ndonjë shoqate apo organizate profesionale, që ofron mundësinë e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në rrugë jashtëgjyqësore, ofruesi specifikon karakteristikat dhe kushtet e zbatimit të saj.

4. Informacioni i parashikuar në këtë nen ofrohet në kohë të mjaftueshme, përpara nënshkrimit të kontratës apo, në mungesë të një kontrate të shkruar, përpara ofrimit të shërbimit.

Neni 14/1

Kontratat e sigurimit dhe garancitë e përgjegjësisë profesionale

1. Për disa shërbime, ofrimi i të cilave paraqet rrezik të posaçëm dhe të drejtpërdrejtë për shëndetin ose sigurinë e përfituesit të shërbimit ose të një pale të tretë, ose rrezik për sigurinë financiare të përfituesit të shërbimit, mund të kërkohej që ofruesit të bëjnë sigurimin e përgjegjësisë profesionale të përshtatshme me natyrën dhe shkallën e rrezikut ose të ofrojnë një tjetër garanci që është ekuivalente ose në thelb e krahasueshme në lidhje me qëllimin e saj.

2. Kur ofruesi vendoset në territorin e Republikës së Shqipërisë, autoritetet kompetente nuk mund të kërkojnë sigurim ose ofrimin e garancive të tjera alternativave nëse, në Shtetin e Vendosijes, ofruesi është tashmë i mbuluar nga një sigurim i barasvlershëm, ose i krahasueshëm në thelb për nga qëllimi, mbulimi i ofruar në lidhje me rrezikun e siguruar, shumën e siguruar ose kufijtë e garancisë, territorin dhe përjashtimet e mundshme nga mbulimi. Në rastin e përputhshmërisë së pjesshme, autoriteti kompetent mund të kërkojë garanci shtesë për sa nuk mbulohet nga sigurimi në Shtetin e Vendosijes.

3. Nëse ofruesit e vendosur në Republikën e Shqipërisë i kërkohet nga autoritetet kompetente nënshkrimi i një kontrate sigurimi për dëmtshpërblim profesional ose një garanci tjetër, vërtetimi për ekzistencën e një sigurimi të tillë, të lëshuar nga institucionet financiare dhe shoqëritë e sigurimit të vendosura në një Shtet Anëtar konsiderohen të mjaftueshme.

4. Për qëllimet e këtij neni:

- a) **“Rrezik i posaçëm dhe i drejtpërdrejtë”** nënkupton një rrezik që vjen drejtpërdrejt nga ofrimi shërbimit;
- b) **“Shëndet dhe siguri”** nënkupton parandalimin e vdekjes ose dëmtimit të rëndë personal të përfituesit të shërbimit ose të një pale të tretë;
- c) **“Sigurim financiar”** nënkupton parandalimin e një humbjeje të konsiderueshme financiare ose rënie të vlerës së pasurisë së përfituesve të shërbimit;
- ç). **“Sigurimi i përgjegjësisë profesionale”** nënkupton sigurimin që një ofrues realizon në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të mundshme ndaj përfituesve të shërbimit dhe, sipas rastit, palëve të treta të përfshira për shkak të ofrimit të shërbimit.”

Neni 15

Në nenin 15, pika 2, fjala “proporcional” zëvendësohet me togfjalëshin “të jetë proporcional”

Neni 15/1

Aktivitetet shumëdisiplinore

1. Ofruesit nuk u nënshtrohen kërkesave që i detyrojnë ata të ushtrojnë ekskluzivisht një veprimtari të caktuar ose që kufizojnë ushtrimin e përbashkët ose në partneritet të veprimtarive të ndryshme. Përjashtimisht mund të jene subjekt i kërkesave të tilla, ofruesit e mëposhtëm:

- a) profesionet e rregulluara, për aq sa është e justifikuar për të garantuar respektimin e rregullave që qeverisin etikën dhe sjelljen profesionale, të cilat ndryshojnë sipas natyrës specifike të çdo profesioni, dhe është e nevojshme për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre;

- b) ofruesit e shërbimeve të certifikimit, akreditimit, monitorimit teknik, testimit ose provës, për aq sa është e justifikuar për të siguruar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre.

2. Në rastin e autorizimit të ofrimit të aktiviteteve shumëdisiplinore ndërmjet ofruesve të listuar në nenin 15/1 , pika 1, shkronjat a) dhe b), sigurohet:

- a) parandalimi i konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë ndërmjet aktiviteteve të caktuara;
- b) pavarësia dhe paanshmëria e nevojshme për aktivitete të caktuara;
- c) pajtueshmëria e ndërsjellë e akteve që rregullojnë etikën dhe sjelljen profesionale për veprimtari të ndryshme, veçanërisht në lidhje me sekretin profesional.

3. Informacioni mbi ofruesit që i nënshtrohen kërkesave të përcaktuara në nenin 15/1, pika 1, përmbajtjen e këtyre kërkesave dhe arsyet që i konsiderojnë ato të justifikuara, raportohet rregullisht sipas kërkesave të Komisionit apo të Shteteve Anëtare.

Neni 15/2

Politika për cilësinë e shërbimeve

1. Në bashkëpunim me Komisionin dhe me propozim të Ministrisë, Këshilli i Ministrave miraton politika për nxitjen e ofruesve për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve përmes:

- a) skemave të certifikimit vullnetar për ofruesit e shërbimeve;
- b) zhvillimit dhe përhapjes së praktikave më të mira për ndërtimin e standardeve të cilësisë apo pjesëmarrjes në organizata profesionale që kanë vendosur standarde të cilësisë në tregun e përbashkët;
- c) programet e trajnimit për rritjen e aftësive profesionale të ofruesve të shërbimeve.

2. Autoritetet kompetente sigurojnë që informacioni mbi rëndësinë e standardeve të cilësisë që lidhen me shërbimet të jetë lehtësisht i qasshëm nga ofruesit dhe përfituesit.

3. Autoritetet kompetente, në bashkëpunim me Komisionin, marrin masa për të nxitur organizatat profesionale, si dhe dhomat e tregtisë, shoqatat e zejeve dhe ato të konsumatorëve, brenda territorit të tyre, që të bashkëpunojnë për të promovuar cilësinë në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht duke lehtësuar procesin e vlerësimit të aftësive të ofruesit.

4. Autoritetet kompetente, në bashkëpunim me Komisionin, marrin masa për të nxitur zhvillimin e vlerësimeve të pavarura, sidomos nga shoqatat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë dhe defektet në ofrimin e shërbimeve, dhe në veçanti zhvillimin e testeve krahasuese dhe komunikimin e rezultateve.

5. Autoritetet kompetente, në bashkëpunim me Komisionin, inkurajojnë zhvillimin e standardeve vullnetare evropiane me qëllim lehtësimin e përputhshmërisë ndërmjet shërbimeve të ofruara nga ofruesit në shtete të ndryshme anëtare, rritjen e informimit të përfituesve dhe përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve.

Neni 15/3

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Autoritetet kompetente marrin masat e nevojshme për të siguruar që ofruesit e shërbimeve të ofrojnë të dhëna të plota të kontaktit, duke përfshirë adresën postare, numrin e faksit, adresën e *email*-it dhe numrin e telefonit, të gjithë përfituesit, përfshirë ata që banojnë në një Shtet tjetër Anëtar, të kenë mundësinë të dërgojnë ankesa ose kërkesa për informacion mbi shërbimin e ofruar. Ofruesit deklarojnë adresën e tyre të regjistruar, nëse kjo ndryshon nga adresa e zakonshme e korrespondencës. Autoritetet kompetente marrin masat e nevojshme për të siguruar që ofruesit t'u përgjigjen ankesave në kohën dhe të bëjnë përpjekjet maksimale për të gjetur zgjidhjen e tyre.

2. Autoritetet kompetente marrin masat e nevojshme për të siguruar që ofruesit të jenë të detyruar të përmbushin detyrimet të përcaktuara në këtë ligj në lidhje me dhënien e informacionit dhe të garantojnë që informacioni i dhënë është i saktë.

3. Kur kërkohet një garanci financiare për përmbushjen e një vendimi gjyqësor, Republika e Shqipërisë njeh garancitë ekuivalente të depozituara pranë një institucioni krediti ose siguruesi të vendosur dhe rregullisht të autorizuar për lëshimin e këtyre garancive në një Shtet tjetër Anëtar.

4. Autoritetet kompetente marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ofruesit e shërbimeve që i nënshtrohen një kodi etik ose janë anëtarë të një shoqate apo organi profesional, i cili ofron mekanizma jashtëgjyqësorë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, të informojnë përfituesit e shërbimeve dhe të paraqesin qartë mënyrën se si mund të qaset dhe të përdoret ky mekanizëm.

Neni 13

Pas Kreut IV shtohet Kreu IV/I “Bashkëpunimi Administrativ”, me këtë përmbajtje:

“KREU IV/I

BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV

Neni 15/4

Bashkëpunimi administrativ me Shtetet Anëtarë dhe Komisionin

1. Autoritetet kompetente bashkëpunojnë me Shtetet Anëtare nëpërmjet Sistemit e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI) për të dhënë ndihmë të ndërsjellë dhe zbatojnë masa të posaçme, në mënyrë që të sigurojnë mbikëqyrjen e ofruesve dhe të shërbimeve që ata ofrojnë.

2. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim, institucionin përgjegjës për ndërveprimin me Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm, si dhe detyrat, kompetencat dhe funksionimin e tij. Ky institucion përcakton koordinatorin/ët e Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm dhe koordinon pikën e kontaktit për çdo autoritet kompetent.

3. Kërkesat për informim dhe kërkesat për realizimin e kontrolleve, inspektimeve dhe hetimeve në bazë të këtij kreu duhet të jenë të motivuara, sidomos duke specifikuar arsyen e kërkesës. Informacionet e shkëmbyera përdoren vetëm në lidhje me çështjet për të cilën kërkohen.

4. Kur marrin kërkesë për asistencë nga autoritetet kompetente, koordinatoret e Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm japin të gjitha informacionet që nevojiten për mbikëqyrjen e veprimtarive të tyre në përputhje me ligjet e zbatueshme.

5. Koordinatori i Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm nëse has vështirësi në përmbushjen e kërkesës për informim apo në realizimin e kontrolleve, inspektimeve a hetimeve, informon menjëherë Shtetin Anëtar kërkues, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje.

6. Autoritetet kompetente në bashkëpunim me koordinatorët e Sistemit e Informacionit të Tregut të Brendshëm, ofrojnë shërbimin nëpërmjet mjeteve elektronike sa më shpejt të jetë e mundur.

7. Koordinatori Kombëtar i Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm siguron që regjistrat ku janë regjistruar ofruesit e shërbimeve++, të cilët janë të aksesueshme nga autoritetet kompetente brenda territorit të tyre, janë të aksesueshme, me të njëjtat kushte, edhe nga autoritetet kompetente simotra të Shteteve Anëtare.

8. Koordinatori Kombëtar i Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm informon Komisionin për rastet kur Shtetet Anëtarë nuk përmbushin detyrimet e tyre në lidhje me bashkëpunimin administrativ.

Neni 15/5

Ndihma e ndërsjellë, detyrimet e përgjithshme për ofruesit e vendosur në Republikën e Shqipërisë

1. Koordinatori i Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm jep informacionin e nevojshëm, me kërkesën e Shtetit Anëtar tjetër dhe konfirmon nëse ky ofrues është i vendosur në këtë territor apo nëse ushtron veprimtari në mënyrë të paligjshme.

2. Autoritetet kompetente kryejnë kontrollet, inspektimet dhe hetimet e kërkuara nga një Shtet Anëtar dhe e informojnë këtë të fundit për rezultatet dhe sipas rastit, për masat e marra. Autoritetet kompetente mund të vendosin për masat e përshtatshme që duhen marrë në çdo rast individual për të plotësuar kërkesën e një Shteti Anëtar.

3. Koordinatori Kombëtar i Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm, pasi merr dijeni për sjellje a vepra specifike të një ofruesi të vendosur në territorin e Republikën e Shqipërisë, i cili ofron shërbime në Shtete Anëtare të tjera, të cilat mund të dëmtojnë rëndë shëndetin a jetën e personave ose mjedisin, informon sa më shpejt të gjithë Shtetet Anëtare të tjera dhe Komisionin.

Neni 15/6

Mbikëqyrja që bëjnë autoritet kompetente në rast të zhvendosjes së përkohshme të ofruesit në një Shtet Anëtar tjetër

1. Autoritetet kompetente kujdesen që kërkesat ligjore të mbikëqyrjet në përputhje me kompetencat e mbikëqyrjes që parashikon ligji i zbatueshëm, në veçanti nëpërmjet masave mbikëqyrëse të zbatuara në shtetin ku është i vendosur ofruesi.

2. Autoritetet kompetente, për ofruesit e vendosur në Republikën e Shqipërisë, kanë të drejtën të marrin masa mbikëqyrëse ose shtrënguese kur shërbimi është ofruar ose është shkaktuar dëm në një Shtet Anëtar.

3. Autoritetet kompetente nuk kanë detyrimin të bëjnë kontrolle faktike në territorin e Shtetit Anëtar ku ofrohet shërbimi. Këtë kontroll e bëjnë autoritetet përkatëse të Shtetit Anëtar ku ushtron aktivitet përkohësisht ofruesi, me kërkesën e autoriteteve të Shtetit Anëtar të Vendosjes.

Neni 15/7

Mbikëqyrja në rast të zhvendosjes së përkohshme të ofruesit

1. Autoritetet kompetente marrin pjesë në mbikëqyrjen e veprimtarisë së ofruesve në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në veçanti, autoritetet kompetente:

- a) Marrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që ofruesit të respektojnë kërkesat e përmendura më sipër lidhur me hyrjen në veprimtari dhe ushtrimin të saj;
- b) Kryejnë kontrollet, inspektimet dhe hetimet e nevojshme për mbikëqyrjen e shërbimeve të ofruara.

2. Për kërkesat që nuk përmenden në paragrafin 1, kur një ofrues zhvendoset përkohësisht në një Shtet Anëtar për të ofruar një shërbim pa qenë i vendosur atje, autoritetet kompetente të atij Shteti Anëtar marrin pjesë në mbikëqyrjen e ofruesit në përputhje me paragrafët 3 dhe 4.

3. Me kërkesë të Shtetit të Vëndosjes, autoritetet kompetente të Shtetit Anëtar ku ofrohet shërbimi kryejnë çdo kontroll, inspektim dhe hetim të nevojshëm për të siguruar mbikëqyrjen efektive nga Shteti i Vëndosjes. Në këtë mënyrë, autoritetet kompetente veprojnë në masën e lejuar nga kompetencat e tyre. Autoritetet kompetente mund të vendosin për masat më të përshtatshme të zbatueshme në secilin rast individual për të përmbushur kërkesën e Shtetit të Vëndosjes.

4. Me iniciativën e tyre, autoritetet kompetente mund të kryejnë kontrolle në terren, inspektime dhe hetime lidhur me ofruesit e shërbimeve brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me kusht që këto masa të jenë jo-diskriminuese, të mos bazohen në Shtetin e Vëndosjes së ofruesit dhe të jenë proporcionale.

Neni 15/8

Masat paralajmëruese

1. Nëse një autoritet kompetent vihet në dijeni të akteve ose rrethanave të lidhura me një aktivitet shërbimi, të cilat mund të dëmtojnë seriozisht shëndetin ose sigurinë e individëve apo mjedisin në territorin e Republikës së Shqipërisë ose të një Shteti Anëtar, informon Shtetin Anëtar të vendosjes, Shtetet Anëtare të përfshira dhe Komisionin, brenda një periudhe sa më të shkurtër kohore.

2. Autoritetet kompetente promovojnë pjesëmarrjen në rrjetin Evropian të Shteteve Anëtare për të zbatuar paragrafin 1.

3. Ministria është përgjegjëse për zbatimin e rregullave të miratuara nga Komisioni për përditësimin e mekanizmave dhe masave të paralajmërimit.

Informacion për reputacionin e ofruesve të shërbimit

1. Në bazë të një kërkesë me shkrim nga një Neni 15/9

Shtet Anëtar, autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin përkatës, përcjellin në mënyrë elektronike informacionin mbi masat disiplinore ose administrative, sanksionet penale dhe vendimet që lidhen me falimentimin ose paaftësinë paguese, duke përfshirë mashtrimin dhe krimin ekonomik, të marra nga autoritetet kompetente në lidhje me ofruesin, kur këto masa janë drejtpërdrejt të rëndësishme për aftësitë dhe besueshmërinë profesionale të tij.

2. Autoriteti kompetent informon edhe ofruesin për informacionin e përcjellë tek Shteti Anëtar kërkues. Kërkesa e bërë sipas paragrafit 1 paraqitet e justifikuar dhe e shoqëruar me arsyetim të qartë për objektin e informacionit të kërkuar.

3. Sanksionet dhe masat e përmendura në paragrafin 1 komunikohen vetëm kur është marrë një vendim përfundimtar dhe i detyrueshëm për ekzekutim. Për vendimet e tjera të zbatueshme të

përmendura në paragrafin 1, informacioni i përcjellë përmban sqarimin nëse vendimi është përfundimtar dhe i detyrueshëm apo nëse ndodhet ende në proces ankimi. Në këto raste, autoriteti kompetent raporton edhe datën e pritshme të hyrjes në fuqi të formës së prerë dhe të ekzekutueshme të vendimit.

4. Autoriteti kompetent është i detyruar të specifikojë bazën ligjore mbi të cilën është marrë vendimi përfundimtar.

5. Zbatimi i paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni kryhet në përputhje me parashikimet për mbrojtjen e të dhënave personale dhe duke respektuar të drejtat e garantuara për personat e shpallur fajtorë ose të dënuar në Shtetet Anëtare përkatëse, përfshirë edhe vendimet e organizatave profesionale. Informacioni i tillë, kur është publik, vihet në dispozicion të konsumatorëve.

Neni 15/10

Ndihma e ndërsjellë në rast të përjashtimeve individuale

1. Kur autoritetet kompetente synojnë të ndërmarrin një masë në përputhje me Nenin 9/3, procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 5 të këtij neni zbatohet, pa cenuar procedurat gjyqësore, përfshirë procedurat paraprake dhe aktet e kryera në kuadër të një procesi penal.

2. Autoritetet kompetente i kërkojnë Shtetit të Vendosijes ndërmarrjen e masave lidhur me ofruesin, duke i vënë në dispozicion të gjitha informacionet përkatëse mbi shërbimin përkatës dhe rrethanat e çështjes. Për ofruesit e shërbimeve të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, autoritetet kompetente kryejnë, sa më shpejt të jetë e mundur, verifikimin nëse ofruesi ushtron veprimtarinë në mënyrë të ligjshme dhe shqyrtojnë faktet mbi të cilat bazohet kërkesa. Autoriteti kompetent informon Shtetin Anëtar kërkuar, sa më shpejt, mbi masat e marra ose të parashikuara, ose, sipas rastit, mbi arsyet e mosmarrjes së masave.

3. Pas komunikimit nga autoritetet kompetente të Shtetit të Vendosijes mbi faktet, masat e marra ose të planifikuara, ose arsyet e mosmarrjes së masave, autoritetet kompetente njoftojnë Komisionin dhe Shtetin e Vendosijes për synimin e tyre për të ndërmarrë masa, duke specifikuar:

- a) arsyet pse besojnë se masat e marra ose të planifikuara nga Shteti i Vendosijes janë të papërshtatshme;
- b) arsyet pse besojnë se masat që synojnë të ndërmarrin përmbushin kushtet e përcaktuara në Nenin 9/3.

4. Masat mund të ndërmerren pas përfundimit të një periudhe prej pesëmbëdhjetë ditësh pune nga data e njoftimit të përcaktuar në paragrafin 3.

5. Përjashtimisht, në rast urgjence, masa mund të ndërmerret pa ndjekur procedurat e parashikuara më sipër. Në këto raste, masa i njoftohet sa më shpejt të jetë e mundur Komisionit dhe Shtetit të Vendosijes, duke shpjeguar arsyet e urgjencës.

6. Sa më sipër nuk paragjykon të drejtën e Komisionit për të vendosur mbi pajtueshmërinë e masës me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe për të marre vendimet përkatëse mbi vlefshmërinë e masës.

Neni 15/11

Thjeshtimi i procedurave administrative

1. Autoritetet kompetente shqyrtojnë procedurat që zbatohen për qasjen në një aktivitet shërbimi dhe ushtrimin e tij.

2. Autoritetet kompetente bazohen në formularët e harmonizuar, të hartuar nga Komisioni të cilët janë të barasvlershëm me certifikatat, vërtetimet dhe çdo dokument tjetër që kërkohet nga një ofrues.

3. Kur është e nevojshme që një ofrues ose përfitues të paraqesë një certifikatë, vërtetim ose ndonjë dokument tjetër që dëshmon se një kërkesë është plotësuar, autoritetet kompetente pranojnë dokumentet nga një Shtet Anëtar tjetër, për sa kohë ato kanë të njëjtin qëllim ose bëhet e qartë se kërkesa përkatëse është përmbushur.

4. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe me ligj të veçantë ose kur kërkesa justifikohet nga një arsye mbizotëruese që lidhet me interesin publik, përfshirë rendin dhe sigurinë publike, nuk kërkohet paraqitja e dokumenteve në formën origjinale, si kopje të certifikuara ose si përkthime të certifikuara.

5. Autoritetet kompetente ruajnë të drejtën të kërkojnë përkthime jo të certifikuara të dokumenteve në gjuhën zyrtare të vendit.

Neni 15/12

Dhënia e informacionit

1. Ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë dhe tregtisë, në bashkëpunim me Koordinatorin Kombëtar të Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm dhe autoritetet kompetente, harton dhe paraqet në Komisionin Evropian raporte periodike për çështjet e mëposhtme:

- a) skemat e autorizimit sipas nenit 4 të ligjit;
- b) kërkesat që duhet të vlerësohen sipas nenit 6;
- c) kufizimet mbi aktivitetet shumëdisiplinore sipas nenit 15/1;
- d) kërkesat kombëtare që kufizojnë ofrimin e shërbimeve ndërkufitare sipas nenit 9/1.

2. Mënyra, afatet, forma dhe procedurat për hartimin, miratimin dhe dorëzimin e raporteve të përmendura në pikën 1 përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Neni 16 ndryshohet si me poshtë:

1. Në përputhje me dispozitat e neneve 4 – 9, 9/1, 14/1, 15 dhe 15/1 të këtij ligji, autoritetet kompetente shqyrtojnë kriteret dhe dispozitat ekzistuese të legjislacionit që rregullon shërbimet për të përcaktuar përputhshmërinë me këtë ligj, ose, sipas rastit, ndërmarrin ndryshimet përkatëse.

2. Autoritetet përgjegjëse për rishikimin e legjislacionit dhe metodologjia për shqyrtimin e përputhshmërisë së kriterëve ekzistuese me këtë ligj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 15

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1, si më poshtë:

“1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të miratojë vendimet në zbatim të nenit 15/2 pika 1, neni 15/4 pika 2, dhe neni 15/12 pika 2 të këtij ligji brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e tyre.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për ndryshimin e vendimeve ekzistuese, lidhur me nenin 6 pika 3 të ligjit ekzistues dhe nenit 16 të këtij ligji, në funksion të zbatimit të parashikimeve të këtij ligji.”

Neni 16

Hyrja ne fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

2. Përjashtimisht, neni 1, për sa e zbatueshme për aktivitetin ndërkufitar, neni 4 pika, 4/1, 10/1, 14/2, 14/3, 14/4 dhe 16, neni 6 pika 1, 1/1, 1/2, 1/3, neni 7 pika 3 dhe 4, neni 8, neni 10, neni 12 dhe neni 13 të këtij ligji hyjnë në fuqi në momentin e anëtarësimit të plotë dhe të pakushtëzuar të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.”

KRYETARE

ELISA SPIROPALI